



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
VRHOVNI SUD KOSOVA – SUPREME COURT OF KOSOVO

Numri i lëndës: 2023:074930
Datë: 22.12.2023
Numri i dokumentit: 05110611

C-IV-14- 7293

Paditës: A S nga Prizreni të cilën me autorizim e përfaqëson avokati B I nga Prishtina.

Kundër

Të paditurës: Ndërmarrja Shoqërore „ Komuna ” në likuidim të cilën e përfaqëson Agjencia Kosovare e Privatizimit në Prishtinë, rr. „Driton Hoxha ”, nr. 55.

Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit, me gjyqtarin Hasim Sogojeva, me 18 dhjetor 2023, mori këtë :

A K T G J Y K I M

APROVOHET si e bazuar ankesa/kërkesa e paditëses dhe ndryshohet Vendimi i Autoritetit të Likuidimit për NSH „ Komuna ”, PRZ 035- 0180/50, dt. 30.09.2013, obligohet e paditura NSH „Komuna ”, që paditësit A S për paga të papaguara për periudhën 01.01.2004 deri më 31.12.2005, t’ ia paguaj shumën 2,178.00€, si dhe për shpenzime të procedurës në shumën 124.00€, sipas nenit 40.1.1.7, të Shtojcës së Ligjit nr. 04/L-034.

Rrethanat Faktike dhe Procedurale

Në vitin 2013, pranë DHPGJS është parashtruar ankesa/ kërkesa e paditësit, dhe e grupit të punëtoreve kundër të paditurit, në lidhje me Vendimet e Autoritetit Likuidues (AL) për NSH „ Komuna ” me të cilat janë refuzuar kërkesat për pagesat e pagave të pa paguara . Rasti është regjistruar si, C- IV- 13- 2716, por që me Urdhër të Gjykatës, C- IV- 13- 2716, dt. 28.10.2014, kjo lëndë është ndarë dhe ka marrë shenjën, si C- IV- 14- 7293. Me ankesë nga paditësi është goditur Vendimi i të paditurit më PRZ 035 – 0180/50, dt. 30. 09. 2013, me të cilin është refuzuar si e pa vlefshme kërkesa e paditësit A S për kompensim të pagave të pa paguara për periudhën janar 2004 deri në dhjetor të vitit 2005, në shumën 2,178.00€ .

Në parashtrësë të dt. 01.12.2014, i autorizuari i paditëses është deklaruar se ankesën e ushtron për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës, vërtetimit të gabuar të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të drejtës materiale .

Në parashtrësë është deklaruar se paditësi ka punuar te i padituri prej dt. 01.09.1984 deri më dt. 27.03.2007, kur të njëjtës ju është ndërprerë marrëdhënia e punës si pasojë e privatizimit .

Pas fillimit të procedurës së falimentimit paditësi dhe grupi i punëtorëve kanë ushtruar kërkesë kolektive për pagat e pa paguara te AL .

Autoriteti i Likuidimit me Vendimin PRZ 035- 0180/50, dt. 30.09.2013, e ka refuzuar kërkesën e paditësit si të pavlefshme .

Me rastin e nxjerrjes së Vendimit, AL nuk e ka bërë vërtetimin e plotë të gjendjes faktike dhe ka zbatuar në mënyrë të gabuar të drejtën materiale kur ka konstatuar se kërkesa e paditësit është parashkruar sipas nenit 608 të Ligjit për punën e bashkuar .

Ka kërkuar të miratohet në tërësi ankesa dhe të pranohet kërkesa e paditësit për paga të pa paguara për periudhën dt.01.01.2004 deri më dt. 31.12.2005, në shumën 2,178.00€ si dhe shpenzimet e procedurës .

Kësaj parashtrëse ja ka bashkangjitur :

- Vendimin e AL PRZ 035- 0180/50, më dt.30.09.2013,
- Njoftim i për fillimin e procedurës së likuidimit i lëshuar nga AKM-ja.
- Njoftimin për ndërprerje të marrëdhënies së punës, dt. 27.03.2007,
- Dokumentin identifikues,
- Deklarata e punëtorit,
- Libreza e punës,
- Lista e pagave për vitin 2004 dhe 2005.

Më dt. 31.10.2023 , Dhoma e Posaçme Gjykatës Supreme e Kosovës, ka lëshuar Urdhër C- IV- 15- 7264, si për paditësen ashtu edhe për të paditurin AKP-ja .

Paditësit ju është kërkuar të paguaj taksën gjyqësore , ndërsa të paditurit ju është kërkuar të jep përgjigje në ankesë .

Më dt. 21.11.2023 , AKP-ja përmes përfaqësuesit të saj ka dorëzuar parashtrësën në mbrojtje ndaj ankesës të ushtruar kundër Vendimit të AL PRZ 035- 0180/44, me propozim që ankesa të refuzohet.

Në parashtrësë është deklaruar se NSH „Komuna ” ka hyrë në procedurë të likuidimit më dt. 06.03.2008, ndërsa paditësi ka ushtruar kërkesë kreditore më dt. 12.05.2008, duke kërkuar kompensimin për paga të pa paguara për periudhën janar 2004 deri në dhjetor të vitit 2005, në shumën 2,178.00€ .

Autoriteti i Likuidimit me Vendimin PRZ 035- 0180/44, ka refuzuar kërkesën. Vendimi është i mbështetur në faktet dhe bazat ligjore në vijim:

- Neni 36.2.1 i Shtojcës së Ligjit nr. 04/L-034, ka paraparë „ elementet në vijim përbejnë bazë të mirë dhe të mjaftueshme ligjore sipas ligjit aktual për refuzim të Kërkesës apo kapitalit të pretenduar apo interesit të pronësisë ..kërkesa apo pretendimi është i parashkruar sipas kufizimeve kohore të aplikueshme ”.

- Neni 608, i Ligjit të punës së bashkuar , ka paraparë që parashkrimi i kërkesave nga marrëdhënia e punës është paraparë për tri vite.

AKP-ja në parashtrësë pretendon se kërkesa duhet të jetë e paraqitur në gjykatë apo ndonjë autoritet kompetent brenda tre vjetësh nga momenti kur NSH pretendohet të mos ketë përmbushur obligimet e saj ndaj parashtruesit të kërkesës që rrjedh nga marrëdhënia e punës e që është 3 vjet nga vitit 2004.

Arsyetimi Ligjor

Ankesa/Kërkesa e paditësit , është e bazuar.

Në bazë të nenit 76.3 të Ligjit Nr.06/L-086 të DHPGJS në lidhje me nenin 398 të Ligjit mbi Procedurën Kontestimore, Gjykata përcakton se faktet relevante të rastit janë të pakontestueshme dhe nxjerrë këtë aktgjykim pa caktuar seancë dëgjimore.

Gjykata ka shqyrtuar provat të cilat i kanë ofruar palët ndërgjyqës, ka konstatuar se nuk është si kontestues fakti se paditësi, ishte punëtorë e të paditurës NSH „ Komuna ” në likuidim, deri në ditën kur ju është lëshuar njoftimi nga AKM-ja, më dt. 27.03.2007, sikundër edhe mos pagesa e pagave për periudhën kontestuese dhe lartësia , por si kontestuese sipas të paditurës është parashkrimi i kërkesës .

Sipas provës së njoftimit dt. 27.03.2007 të lëshuar nga AKM –ja për paditësin A S është theksuar, „Pasojë e shitjes së aseteve është përfunduar punësimi i juaj për arsye të tepricës dhe kjo letër është njoftim zyrtar për ju se punësimi juaj përfundon menjëherë ” pastaj vazhdon „Shuma – Pagat që u janë borxh juve sipas kontratës tuaj të punësimit me punëdhënësin do të mbesin përgjegjësi e punëdhënësit . Kërkesat e tilla do të shqyrtohen sipas procedurave të likuidimit dhe ju do të kontaktoheni kur të fillojnë këto procedura ” .

Me provën e listës së pagave të pa paguara për punëtorët e NSH „ Komuna ”, për periudhën, e vitit 2004 dhe vitit 2005, vërtetohet se paditësi ishte në listë të pagave me numër rendor 50 ashtu që për vitin 2004, ju janë llogaritur pagat e pa paguara në shumën 1,640,01€, ndërsa për vitin 2005 ju është llogaritur shuma e pagave 679.22 € .

Gjykata bazuar në Vendimin e Autoritetit të Likuidimit PRZ 035 – 0180/50, dt. 30.09.2013, ka vërtetuar faktin se kërkesa e paditëses është refuzuar për pagimin e pagave për periudhën prej dt. 01.01. 2004 deri më 31.12.2005, në shumën bruto 2,178.00€, si e pavlefshme duke u mbështetur në nenin 36.2.1 të Shtojcës së Ligjit, nr. 04/L-034 dhe në nenin 608 të Ligjit të Punës së Bashkuar .

Gjykata vlerëson se njoftimi i AKM-së , dt. 27.03.2007 për paditësin me të cilin ka përfunduar punësimi për shkak të shitjes së aseteve të ndërmarrjes, ka prodhuar efekt juridike si për paditësin si punëtor ashtu edhe për ndërmarrjen, si punëdhënës sa i përket të drejtave dhe obligimeve të krijuara nga marrëdhënia e punës deri më dt. 27.03.2007. Po ashtu ky njoftim ka prodhuar efekt juridike edhe në lidhje me borxhet /pagat e pa paguara deri në ditën e lëshimit të tij, si për paditësin ashtu edhe për të paditurin.

Gjykata vlerëson se në kohën kur paditëses i ka pushuar marrëdhëniet e punës dt. 27.03.2007, si Ligji i punës në fuqi, ka qenë Rregullorja nr. 2001/27, për Ligjin Themelore Të Punës në Kosovë, si dhe Ligji mbi marrëdhëniet e detyrimeve (LMD i RSFJ i vitit 1978), që ka rregulla të përgjithshme në lidhje me parashkrimin e kërkesave .

Me dispozitën e nenit 40 paragrafi 1. pika 1.7 të Shtojcës së Ligjit nr. 04/L-034 rregullohet „ kërkesat e pa siguruara përfshirë; Kërkesat për paga që nuk janë subjekt i trajtimit me prioritet më të lartë ” .

Gjykata vlerëson se nisur nga fakti se kërkesa kreditore e paditëses, është dorëzuar më dt. 12.05.2008, tek AKM/AKP-ja , ndërsa njoftimi për pushimin e marrëdhënies së punës është lëshuar nga AKM-ja , dt. 27.03.2007 , me të cilin ka pohuar pagat e mbetura borxh, ky njoftim ka efektin juridikë të ndërprerjes së parashkrimit sipas dispozitës së nenit 387 të LMD-së (RSFJ) . Në rastin konkret pas ndërprerjes së parashkrimit, parashkrimi fillon të rrjedh përsëri nga fillimi, kurse koha e kaluar para ndërprerjes nuk llogaritet në afatin e caktuar ligjor për parashkrim, krejt kjo sipas dispozitës së nenit 392 , paragrafi 1, të LMD -së .

Mirëpo nisur nga fakti se AKM-ja/ AKP-ja ka marr për obligim ta njoftoi paditësen kur të fillojnë procedurat e likuidimit, ndërsa fillimi i procedurës së likuidimit është varur nga veprimi i AKP-së (si shkak i pezullimit) , kjo situatë juridike ka ndikuar që rrjedhja e parashkrimit të pezullohet, pra fare të mos filloi të rrjedh parashkrimi, dhe një qëndrim i tillë mbështetet në analogji të dispozitës së nenit 384, paragrafi 1, i Ligjit mbi marrëdhëniet e detyrimeve i RSFJ .

Në rastin konkret për shkak të pezullimit të rrjedhjes së parashkrimit, parashkrimi fare nuk ka rrjedh deri në ditën kur paditësi është njoftuar për fillimin e procedurës së likuidimit nga AKP-ja .

Gjykata vlerëson se pas konstatimit të kësaj gjendje faktike, e cila ndryshon nga konstatimi i gjendjes faktike nga Autoriteti i Likuidimit, Autoriteti i Likuidimit ka konstatuar në mënyrë të gabuar faktin se është parashkruar kërkesa dhe si rrjedhojë e kësaj ka zbatuar në mënyrë të gabuar edhe dispozitën e nenit 36.2.1, të Shtojcës së Ligjit nr. 04/L-034 .

Gjykata vlerëson se në rastin konkret, paditësit nuk është ju parashkruar kërkesa e tij kreditore për pagat e pa paguara për periudhën prej dt. 01.01. 2004 deri më dt. 31.12.2005 , në shumën 2,178.00€ dhe se të njëjtës , ju njihet e drejta për kompensimin e pagave të pa paguara.

Një qëndrim i tillë juridik, gjykata e mbështet, në dispozitën e nenit 40, paragrafi 1, pika 1.7, të Shtojcës së Ligjit nr. 04/L-034.

Meqenëse Gjykata, ka vërtetuar një gjendje tjetër faktike si më lartë në bazë të provave të dorëzuara nga palët ndërgjyqës dhe pretendimeve të tyre në lidhje me parashkrimin nga ajo që është vërtetuar nga Autoriteti i Likuidimit me Vendimit të ankimuar, Gjykata vendosi që Vendimi PRZ 035- 0180/50, të ndryshohet dhe ta pranoi ankesën, duke vendosur si në dispozitiv

Prandaj bazuar në vërtetimin e kësaj gjendje faktike dhe juridike në pajtim me dispozitën e nenit 54.1 lidhur me nenin 74 të Ligjit nr. 06/L- 086 për Dhomën e Posaçme u vendos si në dispozitiv.

Shpenzimet Gjyqësore:

Në bazë të nenit 63 të Ligjit për Dhomën e Posaçme, u vendos që paditësit ti njihen shpenzimet e procedurës për taks gjyqësore në shumën 20.00 €, për ushtrimin e ankesës në shumë prej 104.00€ si shpenzim për avokatin , ose në shumën e tërësishme 124.00 €.

Këshillë Juridike:

Kundër këtij aktgjykimi mund të parashtrohet ankesë me shkrim në Kolegjin e Apelit të Dhomës së Posaçme brenda 15 ditësh nga pranimi i këtij aktgjykimi. Ankesa duhet të dorëzohet në bazë të nenit 9 paragrafi 6 të Ligjit për Dhomën e Posaçme.

Hasim Sogojeva
Gjyqtar